



Npi – 01/36 datë: 05.03.2026

Duke u Bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e parë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 05.03.2026 miratoi këtë:

## V E N D I M

### PËR FORMIMIN E KOMITETEVE TJERA NË KOMUNËN E SHTIMES

#### I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e parë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më datën: 05.03.2026, me shumicën e votave miratoi Vendimin për formimin e 3 (tri) Komiteteve tjera, në përbërjen e të cilëve do të ketë nga 5 (pesë) anëtarë për secilin Komitet si vijon:

1. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
3. Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm.

#### II

A r s y e t i m: Përbërja e Komiteteve duhet të reflektojë përfaqësimin e entitetve politike në Kuvendin e Komunës së Shtimes, duke përfshirë edhe ekspert të jashtëm.

#### III

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

#### IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Rrahman Jakupi